

SHPALLJE

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Përfshirja ekonomike në bujqësi dhe trajnimi profesional për gratë që jetojnë në zonat rurale”, periudha e zbatimit të projektit korrik 2019 dhjetor 2020 i përkrahur nga Donatori CFD nga Zvicra. Projekti do të përfshijë komunat: Lipjan, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë, dhe Zubin Potok.

Një prej objektivave të projektit është rritja e mundësive për punësim për të rinjtë nëpërmjet punës praktike dhe trajnimit profesional për studentët. Në kuadër të këtij projekti janë paraparë edhe aktivitetet, siç janë: **Trajnimet për punë praktike dhe sistemimi në punë praktike**. Këto aktivitete do të zbatohen në bashkëpunim me Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë.

Andaj **ftohen** studentët nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore si dhe Fakultetin Filozofik, që të aplikojnë për angazhimin në praktika të ndryshme që përshtaten me profesionin e tyre. Numri i studentëve në këtë punë praktikë do të jetë gjithsej 10 për periudhën 2019-2020.

Fillimisht, studentët e përzgjedhur do të vijojnë trajnime 5 ditore në Qendrën Edukuese të Fermerëve –IADK, Sfaraçak i Ulët, komuna Vushtrri në fundin e muajit korrik 2019. Shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit do të kompensohen nga projekti.

Pas përfundimit të trajnimeve, ky grup do të kryej punë praktike 3 mujore në IADK, në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme, ndërsa kandidatet do të kenë një kompensim simbolik, për të mbuluar shpenzimet e ushqimit, të komunikimit dhe të udhëtimit në baza të rregullta mujore. Puna praktike do të bëhet në periudhën gusht 2019 deri në tetor 2020 varësisht nga kërkesat e kandidateve.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara me projekt.

KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR KANDIDATËT JANË :

- Studentët nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti Filozofik-departamenti sociologji, që janë në vitin e fundit të studimeve ose kanë përfunduar studimet dhe që janë pa punë.
- Studentët të interesuar për praktikë duhet të jenë nga këto komuna përkatëse: Lipjan, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë, dhe Zubin Potok.
- Studentët që shprehin gatishmëri/përkushtim për pjesëmarrje në trajnime dhe në punën praktike në kompani/agrobiznese, institucione dhe organizata tjera duhet të jene të rregullta në trajnime dhe në punë .

Aplikacioni mund të merren në **zyrat e IADK-së**, në adresë fshati Sfaraçak i Ulët, Nr.11, Vushtrri ose online në faqet e internetit: www.iadk.org dhe E-mail hafize_veseli@hotmail.com

Aplikacioni mund të dorëzohet në **zyrat e IADK-së** ose përmes emali: hafize_veseli@hotmail.com, info@iadk.org

Për informata shtese mund të kontaktoni në +383 49 467 531 .

Shpallja për aplikim është i hapur nga data 04.07.2019 deri më 18.07.2019 .

Zenel Bunjaku

Drejtor Ekzekutiv

